

“Terms & Conditions” – “Terma & Kushte”

Këto janë termat dhe kushtet që rregullojnë pjesëmarrjen tuaj në Konkursin Ndërkombëtar të Fotografisë dhe Videove Reels, “Wanderlust in Albania: Photos&Reels International Competition”.

Konkursin Ndërkombëtar i Fotografisë dhe Videove Reels, “Wanderlust in Albania: Photos&Reels International Competition”, është i aksesueshëm në faqen www.wanderlustinalbania.al

Duke pranuar keto terma dhe kushte, ju bini dakord të veproni në përputhje me to dhe ju pranoni se i keni lexuar, kuptuar dhe jeni dakord të veproni në përputhje me të gjitha kushtet dhe termat këtu!

Nëse nuk jeni dakord të veproni në përputhje me Termat dhe Kushtet e paraqitura, ju nuk mund të merrni pjesë në këtë konkurs.

- 1) Ju çlironi plotësisht Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe Kontraktorin nga pretendimet e palëve të treta, mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, për fotografitë dhe videot reels që do të ngarkohen në website nga ju në konkurs si dhe do të çlironi plotësisht Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe Kontraktorin nga pretendimet e agjencive të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave ekskluzive të autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to, duke e përjashtuar Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe Kontraktorin nga çdo përgjegjësi.
- 2) Ju miratoni përdorimin jo ekskluziv dhe pa afat të materialeve të ngarkuara nga ana e Agjencisë Kombëtare të Turizmit.
- 3) Fotografitë/videot reels të ngarkuara, duhet të jenë realizuar brenda dy viteve të fundit.
- 4) Nëse në fotografinë e paraqitur është imazhi i personave të tjerë, ju mbani vetë përgjegjësinë për përdorimin e imazhit të tyre.
- 5) Fotografitë/videot reels, me imazhe jo etike, që promovojnë paragjykitime racore, gjinore, nuditet etj, do të përjashtohen automatikisht nga procesi i vlerësimit.
- 6) Fotografitë ose videot reels duhet të kenë një titull duke cituar tematikën, vitin dhe vendin ku është bërë fotografia ose video reels.
- 7) Fotografitë dhe videot reels duhet të jenë ekskluzivisht me imazhe të Shqipërisë duke iu përmbajtur kategorive të përcaktuara.
- 8) Fotografitë/videot reels, duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme artistike, për t’u bërë objekt vlerësimi nga Juria:
 - a. Fotografia/video reels të paraqesi perspektiva dhe këndvështrime të reja

- b. Fotografitë/videot reels të krijojnë thellësi të figurës dhe dimensione.
 - c. Fotografitë/videot reels të përcjellin kompozime artistike dhe krijuese që ndikojnë vizualisht.
 - d. Fotografitë/videot reels të përcjellin traditat shqiptare me elegancë.
 - e. Fotografitë/videot reels të theksojnë bukurinë natyrore të peizazheve shqiptare.
 - f. Imazhet duhet të ngjallin emocione, të tregojnë histori duke pasur në fokus evidentimin e vlerave të Shqipërisë.
 - g. Videot reels duhet të shprehin kreativitet, inovacion dhe origjinalitet.
- 9) Fotografitë duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme teknike, për t'u bërë objekt vlerësimi nga Juria:
- a. Fotografitë duhet të jenë 10 megapixel e lart.
 - b. Të jenë të ruajtura në format jpg, jpeg, png.
 - c. Të gjitha fotografitë që vijnë nga formate të tjera, me problematika të ruajtjes apo downloadimit përjashtohen nga konkursi.
 - d. Për çdo fotografi të ngarkuar në faqe, duhet të përzgjidhni dhe kategorinë ku do të konkuroni me këtë fotografi.
- 10) Videot reels duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme teknike, për t'u bërë objekt vlerësimi nga Juria:
- a. Videot reels duhet të jenë në formatin 1080*1920 px dhe jo më pak se 10 sekonda.
 - b. Videot reels duhet ti përmbahen tematikave duke evituar publikimin e personave apo identitetin e tyre.
 - c. Të gjitha videot që vijnë nga formate të tjera me problematika të ruajtjes apo downloadimit përjashtohen nga konkursi.
 - d. Për çdo video reels të ngarkuar në faqe, duhet të duhet të përzgjidhni dhe kategorinë ku do të konkuroni me këtë reels.